

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar**

**P1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 23.10.2021

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	30	
2. Problemi 2	10	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Flutra shpk është kompani për prodhimin e ëmbëlsirave për industrinë e shitjes me pakicë.  
Në vijim është paraqitur Bilanci Vërtetues, më 31/12/2020:

	<b>Debi</b>	<b>Kredi</b>
	€	€
Zhvlerësimi i akumuluar - Ndërtesat 1 janar 2020		780,000
Zhvlerësimi i akumuluar - Automjetet - 1 janar 2020		240,000
Zhvlerësimi i akumuluar - Patundshmëritë & Pajisjet - 1 janar 2020		635,000
Shpenzimet administrative	423,510	
Lejimet për borxhet e dyshimta		12,860
Paraja në bankë	365,740	
Ndërtesat (Kosto) 1 janar 2020	1,658,200	
Tatimi i pagueshëm		23,000
Shpenzimet e shpërndarjes	425,160	
Shpenzimet e interesit	35,600	
Shpenzimet e tatimit	22,500	
Pasuritë e patrupëzuara(VNL)	60,000	
Stoqet më 1 janar 2020	312,450	
Investimet afatgjata	300,000	
Të hyrat nga investimet		12,000
Kapitali aksionar - €1 secila		250,000
Kredia afatgjatë		300,000
Automjetet (Kosto) më 1 janar 2020	420,000	
Të arkëtueshmet tjera	15,000	
Patundshmëritë & Pajisjet (Kosto) më 1 janar 2020	1,241,200	
Blerjet	2,458,720	
Fitimi i mbajtur më 1 janar 2020		1,709,050
Rezerva e rivlerësimit		30,000
Të hyrat nga shitja		3,845,240
Llogaritë e pagueshme		326,540
Llogaritë e arkëtueshme	<u>425,610</u>	
	<b>8,163,690</b>	<b>8,163,690</b>

***Ju gjithashtu keni gjetur edhe informacionin si në vijim:***

- (i) Stoqet në fund të numëruara dhe të vlerësuara më 31 dhjetor 2020 janë €346,800. Kjo shumë nuk i ka përfshirë stoqet në vlerë prej €24,360 të cilat janë larguar nga fabrika kryesore e prodhimit të Flutra dhe po ruhen në një nga depot e saj para se të shiten më 1 janar 2021.
- (ii) Gjatë muajit janar 2021, kompania ka pranuar fatura në shumë prej €1,600 për shpenzimet administrative të vitit 2020.
- (iii) Zhvlerësimi ndahet si në vijim:

Ndërtesat ----- Në shumën e rivlerësuar

Patundshmëritë& Pajisjet-----12% Metoda drejtvizore

Automjetet-----20% Metoda e saldove zbritëse

Zhvlerësimi për vitin ngarkohet plotësisht në vitin e shitjes dhe asnjë në vitin e blerjes.

- (iv) Gjatë vitit 2020 Flutra shpk ka shitur patundshmëri dhe pajisje për €30,000. Kjo pasuri kishte koston €120,000 në vitin 2014.
- (v) Ndërtesat ishin rivlerësuar më 1 janar 2020 dhe shuma e tyre ishte €900,000. Një vlerësues i pavarur vlerësoi jetën e mbetur të dobishme të ndërtesave në atë datë në 40 vjet dhe vlerën e mbetur në 100,000 €.
- (vi) Gjatë vitit 2020, Flutra shpk shpenzoi 50,000 € për zhvillimin e një marke të një produkti të prodhuar brenda kompanisë. Flutra shpk kapitalizoi shumën në pasuritë e patrupëzuara edhe pse nuk ishin plotësuar kërkesat e SNK 38. Flutra shpk amortizon këto pasuri brenda 10 viteve dhe shpenzimet e amortizimit përfshihen te shpenzimet administrative.
- (vii) Një klient i Flutra shpk më në fund ka paguar borxhin e keq prej €6,000, i cili është shlyer në vitet e mëparshme. Kjo shumë është arkëtuar në muajin dhjetor 2020. Lejimet për të arkëtueshmet duhet të jenë 4%.
- (viii) Më 1 korrik 2020, Flutra shpk ka marr një kredi afatgjatë shtesë në shumë prej €300,000. Kredia i nënshtrohet një normë interesi vjetore prej 4%. Flutra shpk pagoi interesin aktual për kredinë më 2 janar 2021.

**Kërkohe:**

Përgatitni, në një formë të përshtatshme për publikim, bazuar në SNRF, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar për Flutra shpk për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2020.

Shënim: Të gjitha punimet duhet të tregohen.

**(30 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 1

- i) Stoqet në fund janë  $346,800+24,360=371,160$   
KMSH= $312,450+2,458,720-371,160=2,400,010$
- ii) Debi Shpenzimet administrative 1,600  
Kredi Të pagueshmet tjera (Akrualet) 1,600
- iii) Zhvlerësimi:

### Ndërtesat-Shih shënimin 5:

Zhvlerësimi vjetor  $= (900,000-100,000)/40 \text{ vite} = 20,000$

### Automjetet

Zhvlerësimi vjetor  $= 20\% * \text{VNL} = 20\% * (420,000-240,000) = 20\% * 180,000 = 36,000$

### Patundshmëritë dhe pajisjet

Zhvlerësimi vjetor  $= 12\% * \text{Kosto} = 12\% * 1,241,200 = 148,944$

Shënim: përfshihet edhe zhvlerësimi i pasurisë së shitur sepse është politike të ndahen zhvlerësimi i plotë në vitin e shitjes

Total shpenzimet e zhvlerësimit:  $20,000+36,000+148,944=204,944$

- iv) Zhvlerësimi vjetor i pasurisë së shitur  $= 12\% * \text{Kosto} = 12\% * 120,000 = 14,400$

Pasuria zhvlerësohet për këto vite: 2014 (jo sepse është viti i blerjes)

2015 Po

2016 Po

2017 Po

2018 Po

2019 Po

2020 Po (Sepse ngarkohet zhvl i plotë në vitin e

shitjes)

VNL e pasurisë ne datën e shitjes  $= \text{Kosto} - \text{zhvlerësimi i akumuluar} = 120,000 - (6 \text{ vite} * 14,400) = 120,000 - 86,400 = 33,600$

Shitja e pasurisë	30,000
<u>VNL</u>	<u>33,600</u>
Humbja kapitale	3,600

v) Shuma e rivlerësuar e ndërtesave 900,000  
 - VNL e ndërtesave në datën e rivlerësimit (Kosto-Zhvl i akumuluar)  
1,658,200-780,000= 878,200  
 Rezerva e rivlerësimit 21,800

vi) Shuma prej 50,000 € nuk është dashur të kapitalizohet por të regjistrohet si shpenzime të zhvillimit.

Korrigjimet e duhura janë:

Debi Shpenzimet e zhvillimit 50,000  
 Kredi Pasuritë e patrupëzuara 50,000

Me qenë se pasuritë janë amortizuar për 1 vit për 5,000 eur (50,000/ 10 vite), atëherë duhet të korrigjohet edhe amortizimi

Debi Pasuritë e patrupëzuara (për zvogëlimin e amortizimit të akumuluar) 5,000  
 Kredi Shpenzimet administrative (Shpenzimet e amortizimit ) 5,000

vii) Debi LL/A 6,000  
 Kredi Të hyrat nga borxhet e këqija 6,000

Debi Paraja 6,000  
 Kredi LL/A 6,000

Lejimet për borxhet e dyshimta= 4%\*425,610=17,024.4

17,024.4-12,860 (Lejimet sipas BV)=4,164.4 rrumbullaksuar në 4,164

Debi Shpenzimet e borxheve të dyshimta 4,164  
 Kredi Lejimet për borxhet e dyshimta 4,164

viii) Debi Paraja 300,000  
 Kredi Kredia afatgjatë 300,000

Shpenzimet e interesit për 6 muaj=300,000\*4%/2=6,000

Debi Shpenzimet e interesit 6,000  
 Kredi interesi i pagueshëm 6,000

## Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

Të hyrat nga shitja	3,845,240
KMSH	-2,400,010
Fitimi bruto	1,445,230
Të hyrat tjera:	
Të hyrat nga investimet	12,000
Të hyrat nga borxhet e këqija	6,000
Shpenzimet operative:	
Shpenzimet administrative ( kalkulimi 1)	-420,110
Shpenzimet e shpërndarjes	-425,160
Shpenzimet e zhvlerësimit	-204,944
Shpenzimet e borxheve të dyshimta	-4,164
Shpenzimet e zhvillimit	-50,000
Humbja kapitale	-3,600
Fitimi para interesit dhe tatimit	355,252
Shpenzimet e interesit (35,600+6,000)	-41,600
Fitimi para tatimit	313,652
Shpenzimet e tatimit	-22,500
Fitimi neto	291,152



## Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020

Pasuritë	
Pasuritë jo qarkulluese të trupëzuara	
Ndërtesat(kosto)	900,000
Zhvl. i akumuluar(ndërtesat)	-20,000
VNL e ndërtesave	880,000
Automjetet (kosto)	420,000
zhvl i akumuluar (240,000+36,000)	-276,000
VNL e automjeteve	144,000
Patundshmëritë&Pajisjet (Kosto) (Kalkulimi 2)	1,121,200
Zhvl i akumuluar (Kalkulimi 2)	-697,544
VNL e patundshmërive&Pajisjet	423,656
Pasuritë e patrupëzuara (60,000-50,000+5,000)	15,000
Investimet afatgjata	300,000
<b>Totali i pasurive jo qarkulluese</b>	<b>1,762,656</b>
Pasuritë qarkulluese	
Stoqet	371,160
LL/ A	425,610
Lejimet	-17,024
LL/ A Neto	408,586
Të arkëtueshmet tjera	15,000
Paraja (Kalkulimi 3)	701,740
<b>Totali i pasurive qarkulluese</b>	<b>1,496,486</b>
<b>TOTALI i PASURIVE</b>	<b>3,259,142</b>
<b>EKUITETI</b>	
Kapitali aksionar	250,000
Fitimi i mbajtur (1,709,050+291,152)	2,000,202
Rezerva e rivlerësimit (30,000+21,800)	51,800
<b>Totali i Ekuitetit</b>	<b>2,302,002</b>

**DETYRIMET**

Detyrimet afatgjata	
Kredia afatgjatë (300,000+300,000)	600,000
Detyrimet afatshkurtëra	
LL/P	326,540
Të pagueshmet tjera	1,600
Interesi i pagueshëm	6,000
Tatimi i pagueshëm	23,000
Total detyrimet afatshkurtëra	357,140
<b>TOTAL DETYRIMET</b>	<b>957,140</b>
<b>TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET</b>	<b>3,259,142</b>

## Kalkulimi 1:

Shpenzimet administrative: Sipas BV	423,510
Shënimi 2	+1,600
Shënimi 6	<u>-5,000</u>
	420,110

## Kalkulimi 2:

## Kosto e patundshmërive&amp; pajisjet:

Në fillim	1,241,200
<u>Shitja</u>	<u>-120,000</u>
Në fund	1,121,200

## Zhvlerësimi i akumuluar për patundshmëritë &amp;Pajisjet:

Në fillim	635,000
Shpenzimi i vitit	148,944
<u>Shitja e pasurisë</u>	<u>-86,400</u>
Saldo në fund	697,544

## Kalkulimi 3: Paraja

365,740	sipas BV
30,000	shitja
6,000	nga borxhet e kqija
<u>s300,000</u>	<u>kredia</u>
701,740	

## Problemi 2

Ledioni shpk është një kompani e cila ju ka kërkuar juve, kontabilistit të saj financiar praktikant, të përqëndroheni në finalizimin e seksionit të arkëtueshmeve tregtare të pasqyrave të tij financiare për fundin e vitit 31 Dhjetor 2020. informacioni i mëposhtëm është dhënë për vitin 2020:

	€
Llogaria e arkëtueshme - 31.12.2020 - para korrigjimeve	280,000
Lejimet për borxhet e dyshimta - 31.12.2019	14,600

Saldot e mësipërme nuk reflektojnë korrigjimet që rrjedhin nga zërat më poshtë:

- Gjatë vitit 2020 janë shlyer borxhet e këqija në vlerë prej € 8,200;
- Një klient i Ledionit i ka shkruar kompanisë në muajin Nëntor 2020, duke thënë se do ta paguajë borxhin i cili ishte shlyer më heret gjatë vitit 2020 nga Ledioni shpk. Shuma e këtij borxhi të keq është € 3,000;
- Ledioni ka arkëtuar këtë borxh të keq € 3,000 në Dhjetor 2020 dhe ka deponuar paratë në bankë;
- Në shitjet dhe LL/A e vitit 2020 është përfshirë edhe një shitje me kredi e cila është bërë më 1 janar 2021 në shumë prej € 6,200;
- Lejimet për borxhet e dyshimta duhet të bëhen në 5% të të arkëtueshmeve;

Kërkohet:

- a) Llogaritni saldon përfundimtare të saktë të Llogarive të arkëtueshme tregtare që duhet përfshirë në pasqyrat financiare të Ledionit për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020; **(5 pikë)**
- b) Bazuar në informacionin e mësipërm, bëni regsjitrimet në ditar për të korrigjuar transaksionet. **(5 pikë)**

**Total (10 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

a)

<b>Kalkulimi i saldos së LL/A më 31/12/2020</b>	<b>€</b>
LL/A para korrigjimeve	280,000
Shlyerja e borxhit të keq	(8,200)
Kthimi i borxhit të keq	3,000
Arkëtimi i borxhit të keq	(3,000)
Shitjet gabimisht	<u>(6,200)</u>
LL/A e korrigjuar	<u>265,600</u>
LL/A e korrigjuar	265,600
Lejimet për borxhet e dyshimta - 31.12.2020 (5%)	13,280
Lejimet për borxhet e dyshimta - 31.12.2019	14,600
Rënie në lejimet për borxhet e dyshimta	1,320
LL/A e korrigjuar	265,600
Lejimet për borxhet e dyshimta - 31.12.2020	<u>(13,280)</u>
LL/A neto	252,320

b)

<b>Regjistrimet</b>		
D. Shpenzimet e borxheve të këqija	8,200	
K. Llogaria e arkëtueshme		8,200
D. Llogaria e arkëtueshme	3,000	
K. Shpenzimet e borxheve të këqija		3,000
D. Paraja	3,000	
K. Llogaria e arkëtueshme		3,000
D. Të hyrat nga shitja	6,200	
K. Llogaria e arkëtueshme		6,200
D. Lejimet për borxhet e dyshimta	1,320	
K. Të hyrat nga borxhet e dyshimta		1,320

### Problemi 3

Bilanci Vërtetues i Urani shpk më 30 qershor 2020 nuk është barazuar dhe si rezultat është hapur një llogari pezull me saldo kreditore prej €2,830. Ndërsa gjatë kontrollit të regjistrimeve, u zbuluan gabimet e mëposhtme:

- (a) Një shumë prej 450 € në kolonën e blerjeve ishte harruar, por shumat tjera ishin të sakta.
- (b) Një çek prej €3,500 i cili është marr nga një klient është kthyer nga banka për shkak se i ka kaluar afati. Kompania e Uranit nuk e ka bërë këtë korigjim.
- (c) Mallrat në shumë prej €5,500 të cilat janë kthyer nga një klient znj.Peti, ishin regjistruar si debi në llogarinë individuale të Petit dhe në konton e kthimit të shitjeve.
- (d) Shitja e disa artikujve të Mobiljeve për €3,800 ishin regjistruar në Librin e shitjeve ditore, totali i të cilave ishte postuar në llogarinë e shitjeve.
- (e) Shuma prej €4,300 të cilën e ka borxh një kliente Mira, është harruar në listën e klientëve.
- (f) Zbritjet e lejuara në shumë prej €220 për një klient, janë paraqitur saktë në llogarinë e klientit, mirëpo nuk janë paraqitur tek zbritjet e lejuara.
- (g) Parapagimi i sigurimit prej €3,200 paguar më 30 qershor 2020 për 1 vit, nuk është përfshirë në saldot e Bilancit Vërtetues.

**Kërkohet: Përgatitni regjistrimet e nevojshme për të korigjuar gabimet e mësipërme dhe për të mbyllur llogarinë pezull. (20 pikë)**

#### Zgjidhja e problemit 3

- a) Debi Blerjet 450  
Kredi Llogaria pezull 450
- b) Debi Ll/A 3,500  
Kredi Paraja 3,500

c) Saktë:  
 D: Kthimet e shitjeve 5,500  
 K: Ll/A 5,500

Gabim:  
 D: Kthimet e shitjeve 5,500  
 D: Ll/A 5,500  
 K: Llogaria pezull 11,000

**Korrigjim:**

**D: Llogaria pezull 11,000**  
**K: Ll/A 11,000**

d) D: Të hyrat nga shitja 3,800  
 K: Mobiljet 3,800

e) D: Ll/A 4,300  
 K: Llogaria pezull 4,300

f) D: Zbritjet e lejuara 220  
 K: Llogaria pezull 220

g) D: Parapagimet e sigurimit 3,200  
 K: Llogaria pezull 3,200

Llogaria pezull

c) 11,000	S` 2,830 a) 450 e)4,300 f)220 g)3,200
	S``0

#### **Problemi 4**

Në vijim janë ekstraktet e pasqyrave financiare të kompanisë Marta shpk:

<b>Bilanci i Gjendjes më 31 dhjetor</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
	€'000	€'000
<b>PASURITË</b>		
Pasuritë jo-qarkulluese		
Toka	40,000	60,000
Fabrika dhe pajisjet	30,000	50,000
Orenditë	<u>48,500</u>	<u>120,000</u>
	118,500	230,000
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	22,750	73,250
Llogaritë e arkëtueshme	14,350	22,900
Paraja e gatshme	<u>15,250</u>	<u>21,300</u>
	52,350	117,450
<b>TOTAL PASURITË</b>	<b>170,850</b>	<b>347,450</b>
<b>Ekuiteti dhe Detyrimet</b>		
<b>Ekuiteti</b>		
Aksionet e zakonshme	85,000	120,000
Premia	30,000	45,000
Rezerva e rivlerësimit		20,000
Rezerva e përgjithshme	9,500	9,500
Fitimet e mbajtura	<u>17,300</u>	<u>23,750</u>
	141,800	218,250
Detyrimet afatgjata		
7% Obligacione 2018	-----	75,000
Detyrimet afatshkurtra		
Llogaritë e pagueshme	16,700	41,400
Overdrafti bankar	3,950	2,650
Tatimi i pagueshëm	<u>8,400</u>	<u>10,150</u>
	<u>29,050</u>	<u>54,200</u>
<b>Total Ekuiteti dhe Detyrimet</b>	<b>170,850</b>	<b>347,450</b>

#### **Ekstrakt i P/A për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020:**

	€'000
Fitimi neto para tatimit	32,950
Tatimi	<u>11,500</u>
Fitimi neto pas tatimit	21,450

Informatat shtesë janë në dispozicion për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

- Fabrika dhe pajisjet me vlerë neto në libra prej €5,000,000 ishte shitur për €4,000,000.
- Fabrika e re ishte blerë për €32,500,000.
- Orenditë me vlerë në libra prej €8,500,000 ishin shitur për €9,000,000.
- Fabrika dhe pajisjet zhvlerësohen me 15% në vit, ndërkaq shpenzimet e zhvlerësimit të orendive për vitin janë €10,000,000.
- Obligacionet ishin lëshuar më 01 janar 2020.
- Kompania gjatë vitit ka deklaruar dividendë, shuma duhet të gjindet.

Kërkohet:

Përgatitni për Marta pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020.

**[Total: 20pikë]**



## Zgjidhja e problemit 4

Marta

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

€

Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ	
Fitimi neto para tatimit	32,950
Rregullimet për:	
Zhvlerësimi (llog.1)	17,500
Shpenzimet e interesit (llog.2)	5,250
Fitimi në shitje të pasurive jo-qarkulluese (llog.3)	(500)
Humbja në shitje të pasurive jo-qarkulluese (llog.4)	1,000
Fitimi operativ para ndryshimeve të kapitalit të punës	56,200
Rritja në stoke	(50,500)
Rritja në llogaritë e arkëtueshme	(8,550)
Rritja në llogaritë e pagueshme	24,700
Rrjedha e parasë e gjeneruar nga operacionet	21,850
Interesi i paguar (llog.2)	(5,250)
Tatimi i paguar (llog.5)	(9,750)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti operativ</b>	<b>6,850</b>
Rrjedha e parasë nga aktiviteti investues	
Pagesat për blerjen e pasurive jo-qarkulluese (llog.6)	(122,500)
Pranimet nga shitja e pasurive jo-qarkulluese (llog.7)	13,000
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti investues</b>	<b>(109,500)</b>
Rrjedha e parasë nga aktiviteti financues	
Emetimi i aksioneve	50,000
Emetimi i obligacioneve	75,000
Dividenda e paguar (llog.8)	(15,000)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktiviteti financues</b>	<b>110,000</b>
Rrjedha e keshit gjatë vitit	7,350
Keshi dhe ekuivalentët e tij në fillim të periudhës (llog.9)	11,300
Keshi dhe ekuivalentët e tij në fund të periudhës (llog.10)	18,650
<b>Llogaritja 1: Zhvlerësimi</b>	
Fabrika dhe pajisjet	
Vlera në fillim të vitit	30,000
Shitja	(5,000)
Shtimet (blerjet)	32,500
	57,500
Vlera më 31 dhjetor 2008	50,000
Zhvlerësimi	7,500
Total zhvlerësimi	
Fabrika dhe pajisjet	7,500
Orenditë	10,000

17,500
--------

**Llogaritja 2: Shpenzimet e interesit**

$75,000 \times 7\% = 5,250$

**Llogaritja 3: Fitimi nga shitja e pasurive jo-qarkulluese**

VNT e orendive të shitura	8,500
Shitja	9,000
Fitimi në shitje	500

**Llogaritja 4: Humbja nga shitja e pasurive jo-qarkulluese**

VNL e pajisjeve të shitura	5,000
Shitja	4,000
Humbja në shitje	(1,000)

**Llogaritja 5: Tatimi i paguar**

Detyrimi në fillim të vitit	8,400
Shpenzimet e tatimit gjatë vitit	11,500
	19,900
Detyrimi aktual në fund të vitit	10,150
Shuma e paguar [19,900 - 10,150]	9,750

**Llogaritja 6: Pagesat për blerjen e pasurive jo-qarkulluese**

Orenditë	
Vlera në fillim të vitit	48,500
Shitja e orendive	(8,500)
Zhvlerësimi	(10,000)
	30,000
Vlera aktuale	120,000

Orenditë e blera [120,000 - 30,000]	90,000
-------------------------------------	--------

Total pasuritë jo-qarkulluese të vlera

Orenditë	90,000
Fabrika	32,500
	122,500

**Llogaritja 7: Pranimet për shitjen e pasurive jo-qarkulluese**

Orenditë	9,000
Fabrika	4,000
	13,000

**Llogaritja 8: Dividenda e paguar**

Fitimi i mbajtur në fillim	17,300
Fitimi i vitit	21,450

Fitimi i mbajtur në fund	(23,750)
	15,000
<b>Llogaritja 9: Keshi dhe ekuivalentët e tij në fillim të periudhës</b>	
Saldo e parasë së gatshme	15,250
Overdrafti Bankar	(3,950)
	11,300
<b>Llogaritja 10: Keshi dhe ekuivalentët e tij në fund të periudhës</b>	
Saldo e parasë së gatshme	21,300
Overdrafti Bankar	(2,650)
	18,650

## Problemi 5

**i)** Tiara shpk përdor sistemin kompjuterik për të mbajtur regjistrimet e kontabilitetit. Gjendja e librit të arkës për muajin Maj 2021, është nxjerrur dhe përmbledhur si më poshtë:

	€		€
Saldo në fillim	546	Pagesat	335,966
Arkëtimet	<u>336,293</u>	Saldo në fund	<u>873</u>
	<u>336,839</u>		<u>336,839</u>

Shefi i kontabilitetit të kompanisë ju jep informacionet si më poshtë:

- (a) Ekstrakti bankar për Maj 2021 është pranuar më 1 qershor dhe ka treguar saldon me një mbitërheqe prej 2,954 € në fund të muajit Maj.
- (b) Nuk janë paraqitur nga banka çeqet e paguara ndaj furnitorëve të ndryshëm në shumë prej 7,470 €.
- (c) Çeqet e arkëtuara nga Tiara në total prej 6,816 € ishin paguar në bankë më 31 maj por nuk janë kredituar nga banka deri më 2 qershor.
- (d) Shpenzimet bankare me vlerë 630 € të paraqitura në ekstraktin bankar nuk janë regjistruar në librin e arkës të kompanisë.
- (e) Tri urdhëresa bankare të paraqitura në ekstraktin bankar nuk janë regjistruar në librat e kompanisë: abonimi për gazeta prej 52 €, premia e sigurimit prej 360 € dhe pagesat për normat e biznesit prej 2,172 €.
- (f) Një çek i lëshuar për pagese nga Tiara prej 693 € dhe i paraqitur në bankë më 26 maj është regjistruar gabimisht në librin e arkës si 936 €.
- (g) Çeku prej 510 € i është zvogëluar llogarisë bankare të kompanisë. Ky çek ishte për kompaninë Tara shpk.
- (h) Debitimi direkt mujor i pagueshëm për kompaninë e lizingut prej 1,000 € është paguar gabimisht dy herë nga banka.

### **Kërkohet:**

- a) **Përgatitni një konsolidim bankar më 31 maj 2021 dhe paraqitni shumën e rishikuar të librit të arkës (10 pikë)**

b) Draft pasqyrat financiare të ARTA shpk më 30 Shtator 2021 janë përgatitur, mirëpo ka mbetur një diference në vlerë prej € 6,100, e cila përkohësisht është përfshirë si *kredi* në llogarinë pezull të bilancit të gjendjes së kompanisë.

Gjatë kontrollimeve janë gjetur gabimet si në vijim:

- (1) €6,500 ishin paguar për shpenzimet e mirëmbajtjes së objekteve; në librin e arkës kjo pagesë ishte regjistruar saktë dhe ishte debituar llogaria e objekteve si pasuri në vlerë prej €5,600.
- (2) Një makinë ishte shkatërruar dhe për te ishte pranuar një çek në vlerë prej €7,000 për mbeturinat e makinës në një aksident i cili ishte regjistruar si duhet në librin e arkës mirëpo nuk ishte bërë asnjë regjistrim tjetër. Makina kishte një kosto prej €55,000 dhe zhvlerësim në vlerë prej €8,000. Zhvlerësimi ishte regjistruar si duhet për vitin që mbaron më 30 Shtator 2021, duke e bërë zhvlerësimin e akumuluar të makinave në atë datë €15,000. Ende asnjë regjistrim nuk ishte bërë që të eliminohet kostoja dhe zhvlerësimi i akumuluar i makinës.

Është politikë e kompanisë të mos aplikojë/ngarkojë zhvlerësim për pasuri në vitin e largimit (hedhjes).

***Kërkohet:***

**Përgatitni regjistrimet në ditar , për të korigjuar gabimet, për të regjistruar humbjen në makinë dhe për të pastruar llogarinë pezull.**

**(10pikë)**

**(Totali = 20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 5

a)

### HARMONIZIMI BANKAR

	€	€
Saldo e ekstraktit bankar		(2,954)
Plus:Depozitat në tranzit	6,816	
Çeku i debituar gabimisht	510	
Debi direkte e paguar gabimisht	<u>1,000</u>	
		<u>8,326</u>
		5,372
Minus: çequet e paparaqitura		<u>(7,470)</u>
Saldo e korigjuar e ekstraktit bankar		<u>(2,098)</u>

### LIBRI i ARKES

	€		€
2021		2021	
31 Maj Saldo	873	31 Maj Shpenzimet bankare	630
Gabimi €(936 - 693)	243	Parapagimi i gazetave	52
Saldo e korigjuar	2,098	Sigurimi	360
		Normat e biznesit	<u>2,172</u>
	<u>3,214</u>		<u>3,214</u>
		Saldo e korigjuar ne fund	2,098

**b)**

D:Shpenzimet e mirëmbajtjes	6,500	
K: Objektet-Pasuri		5,600
K: Llogaria pezull		900

*Korrigjimi i gabimit ne postimin e kosos se mirembajtjes te objekteve*

D:Llogaria pezull	7,000	
D: Humbja	40,000	
D:Zhvlerësimi i akumuluar-Makina 8,000		
K:Makina-kosto		55,000

Llogaria Pezull

		Saldo në fillim 6,100
	<u>7,000</u>	<u>900</u>
Saldoe/b	0	Saldo në fund 0